



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 151 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/ 12 / 2022

**VENDIM**

Nr.32, date 27 /12/2022

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGES SE HEC FANGUT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullore për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.12.2022 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, operimit, mirembajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digës së HEC FANGUT të paraqitur nga Shoqëria AYEN AS ENERGI shpk.

Dokumentacioni i kësaj rregulloreje të dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë kërkesat e udhëzimit të KKDM në lidhje me hartimin e këtyre rregulloreve të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020. KTPD i rekomandoi antareve të KKDM të miratojnë rregulloren për shfrytëzimin e digës së HEC Fangut duke patur parasysh që në këtë rregullore të përditesohet rregullorja e shkarkimit të plotave duke përfshirë edhe prurjet e mëdha që vijnë një herë në 100 vjet dhe një herë në 50 vjet. Pas diskutimeve të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të miratojnë Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirembajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digës së HEC Fangut të paraqitur nga Shoqëria AYEN AS ENERGI shpk.
- 2- Ti kërkojë shoqëria AYEN AS ENERGI shpk:
  - Përditesimin e rregullore së shkarkimit të plotave të mëdha duke përfshirë edhe shkarkimet për shkak të prurjeve të mëdha që vijnë një herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet. Për këto raste, kompania AYEN AS ENERGI shpk duhet të parashikojë informimin e institucioneve përkatëse duke përfshirë pushtetin lokal, prefekturën e Lezhës, AKMC dhe KKDM në kohë reale dhe përpara hapjes së portave të shkarkimit.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

